



Mbrojtje nga



PËRMBYTJET

SI NDODHIN PËRMBYTJET?

Përmbytjet janë një nga fatkeqësitë natyrore më të zakonshme që ndodhin kryesisht si pasojë e reshjeve të dendura ose të zgjatura, shkrirjes së papritur të borës dhe akullit, rritjes së nivelit të ujërave nëntokësore dhe përrënjeve.

Pavarësisht nëse jetoni apo jo në zona me rrezik të ulët përmbytjeje, mbani mend se ato mund të ndodhin kudo dhe pa paralajmërim!

Çfarë mund të bëni për të zvogëluar rrezikun e përmbytjeve si dhe dëmet në rast të shfaqjes së tyre?

- Respektoni mjedisin dhe nëse shihni se mbetjet janë depozituar në mënyrë të parregullt dhe përbëjnë kërcënim për rrjedhën normale të ujit, raportoni tek shërbimet kompetente.

Mbani gjithmonë në shtëpi, një çantë të ndihmës së shpejtë, elektrik dore, radio me bateri dhe sigurohuni që të gjithë anëtarët e familjes të dinë se ku janë dhe si t'i përdorin ato.



- Njihuni me rrezikun e përmbytjeve në zonën tuaj. Ndërgjegjësoni njerëzit në shkollën ose vendin tuaj të punës për të zbatuar paralajmërimet dhe për të përgatitur një plan reagimi ndaj përmbytjeve.
- Mbani dokumentet e rëndësishme në ambalazhime rezistentë ndaj ujit dhe krijoni kopje dixhitale të tyre.
- Të keni gjithmonë furnizim me ushqim, ujë të pijshëm dhe ilaçe në rast se duhet të largoheni menjëherë nga shtëpia. Mbani parasysh nevojat specifike të anëtarëve të familjes suaj dhe mos harroni nevojat e kafshëve tuaja shtëpiake. Merrni bateri dhe karikues rezervë për telefonat celularë.

Mundohuni të qëndroni të informuar dhe të ndiqni njoftimet dhe udhëzimet e shërbimeve kompetente.



Gjatë përmbytjeve

- Nëse jeni në bodrum ose në katin e parë, ngjituni në katet e sipërme.
- Ngjituni në nivelin më të lartë të ndërtesës.
- Fikni pajisjet elektrike, gazin dhe energjinë elektrike në çelësin kryesor. Mos i prekni telat dhe pajisjet me duar ose këmbë të lagura. Mos pini ujë rubineti, ai mund të jetë i kontaminuar.
- Nëse shërbimet kompetente ju kanë thënë që të evakuoheni, bëjeni menjëherë.

Nëse gjendeni jashtë:

- Asnjëherë mos lëvizni nëpër argjinaturë dhe mos lëvizni nëpër zona të përmbytura.
- Mos kaloni urat mbi ujra të rrëmbyeshëm. Shmangni nënkalimet, argjinaturat, urat. Lëvizja dhe ndalimi në këto vende mund të jetë shumë i rrezikshëm.
- Shmangni zonat ku është vlerësuar rreziku i rrëshqitjeve të dheut.
- Shkoni sa më shpejt në zonat e larta, duke shmangur drejtimin e argjinaturave apo barrikadave artificiale, që mund të shemben për shkak të reshjeve ose rrjedhës së ujit.
- Shmangni përdorimin e makinës.
- Qëndroni larg ndërtesave të rrethuara nga ujërat. Nëse duhet të futeni, bëni kujdes, mund të ketë ndonjë dëmtim të fshehur, veçanërisht në themelet.

Pas pëmbytjeve

- Gjatë pastrimit, vishni doreza të forta pune, veshje dhe çizme mbrojtëse dhe mbani mburoja ose maska të përshtatshme për fytyrën nëse pastroni mykun ose mbetjet e tjera.
- Shmangni ecjen në ujërat e përmbytjeve pasi ato mund të përmbajnë mbetje të rrezikshme .
- Kujdes nga rreziku i goditjes elektrike. Mos prekni pajisjet elektrike nëse janë të lagura ose qëndrojnë në ujë. Nëse është e sigurt, fiken energjinë, për të shmangur goditjen elektrike.
- Para përdorimit të ujit të pijshëm, sigurohuni që pastërtia e tij të jetë konfirmuar nga shërbimet kompetente. Mos konsumoni ushqim që ka rënë në kontakt me ujin e përmbytjes, ai mund të jetë i kontaminuar.





Ky projekt është i financuar
nga Bashkimi Evropian



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Për më shumë informacione rreth projektit
"Katastrofat nuk njohin kufij 2"
mund të kontaktoni:

Prefekti i Qarkut Shkodër
Rruga "28 Nëntori", 1
4001, Shkodër, Shqipëri
+35522242705
Prefekti.Shkoder@mb.gov.al

ose vizitoni faqen web

www.prefektishkoder.gov.al

NUMRA TË RËNDËSISHËM TË EMERGJENCAVE

Numri unik i emergjencave – 112

Policia - 129

Zjarrfikësit - 128

Ambulanca - 127



MNE - ALB

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI 2014-2020



FORS
MONTENEGRO
Foundation for the Development
of Northern Montenegro

Kjo fletëpalosje u mundësua me asistencën financiare të Bashkimit Evropian.
Përmbytja e saj është përgjegjësi e Prefekturës së Qarkut Shkodër dhe nuk mund të
përdoret në asnjë mënyrë për të pasqyruar pikëpamjet e Bashkimit Evropian.